

Intervistë

Ibrahim Makolli, nënkryetar dhe shef i GP të Aleancës Kosova e Re

Heqja dorë nga e shkuara, është heqje dorë nga e ardhmja

Në një intervistë për të përjavshmen "Focus" nënkryetari i AKR-së Ibrahim Makolli thotë se nuk duhet dhenë çdo gjë për pavarësinë e Kosovës dhe festat kombëtare nuk janë kërcenim për askënd në Kosovë. Ai thotë se kjo qeveri çdo ditë po dëshmon se po punon ad-hoc dhe se duhet respektuar pakon e Ahtisaarit ku flitet edhe për zgjedhje të reja. Sipas tij futja nën kontroll të partive politike të agjencisë Kosovare të Inteligjencës do të ishte fatkeqësi për Kosovën.

Ardian Zejnaj

Focus: Z. Makolli, qeveria e Kosovës së fundi vendosi që nga kalendari i festave zyrtare të heq festat kombëtare, siç është festa e flamurit. Mendoni se kjo qeveri po sillt sikur duhet dhenë çdo gjë për pavarësinë e Kosovës?

Makolli: Tani më u vërtetua edhe në debatin e fundit në Kuvendin e Kosovës, kur u diskutua Ligji për festat zyrtare në Kosovës, se mosprania e 28 Nëntorit, ditës së flamurit si festë zyrtare në Kosovë, ka shkaktuar reagime të mëdha të deputetëve dhe të opinionit në përgjithësi. Pavarësisht faktit se tani Kosova është shtet i pavarur dhe sovran dhe duhet të ndërtoj legjislacionin në mbështetje të të qenit shtet, megjithatë kur lexon edhe pjesën e parë, Preambulën e ligjit në fjalë, thuhet se duhet respektuar të kaluarën, traditën, etj, ndërsa që brenda këtij Ligji kemi vetëm dy festa të cilat në të vërtetë identifikohen me Kosovën, që janë Dita e shpalljes së pavarësisë dhe miratimit të Kushtetutës, por të gjitha festat tjera janë ose festa ndërkombëtare ose festa fetare.

Pavarësisht faktit që mund të kuptohet se 28 Nëntori është festë edhe e një vendi tjetër, në këtë rast i Shqipërisë, megjithatë 28 Nëntori është një nga ngjarjet me të rëndësishme të popullit shqiptarë, e cila i pëlqej ose jo dikujt, duhet të respektohet. Ajo është një festë që nga shqiptarët festohet tani e 500 vjet dhe duhet që edhe tani të vazhdoj, tanimë duke qenë festë zyrtare brenda kalendarit të festave zyrtare në Kosovë. Me gjithë se thuhet se kjo festë do të festohet edhe nëse nuk është në kalendarin zyrtarë, një çështje duhet të kemi parasysh, kjo festë është festuar edhe në kushtet me të vështira që ka kaluar populli shqiptar, madje edhe në kohën e Rankoviqit, kur njerëzit për shkak të festimit të kësaj date jo vetëm që kanë marrë më dhjetëra vjet burg, por edhe janë likuiduar fizikisht.

Prandaj, duhet të festohet dhe populli shqiptarë në Kosovë është i lidhur ngushtë me 28 Nëntorin, e cila daton shumë me herët sesa pretendimet që thuhet tani. Ky ligj duhet të respektojë këtë dhe po ashtu me ligj duhet t'u krijohet mundësia edhe komuniteteve tjera në Kosovë që të shënojnë dhe festojnë datat e rëndësishme për historinë e popullit të cilit i takojnë. Kosova është deklaruar se është shtet demokratik dhe tolerant edhe praktikisht duhet të tregojmë këtë tolerancë. Respektimi i festave kombëtare të cilitdo populli nuk e dëmton Kosovën, përkundrazi e radhit ndër vendet me nivelin me të lartë të demokracisë, tolerancës dhe të respektimit të së kaluarës së tyre. Ky ligj duhet të përmbajë data të tjera të rëndësishme, jo vetëm për të kaluarën e Kosovës, por edhe për të tashmen. Kosova ka një histori e cila duhet të respektohet edhe nga qeveritë e saja.

Mst: Pakoja respekton secilin komunitet, historinë, traditën dhe kulturën e tyre

Focus: A mund të krijojmë shtet apo identitet duke u shkombëtarizuar, sepse kjo ashtu tingëllon?

Makolli: Nuk jam i prirë të mendoj se po shkombëtarizohemi. Natyrisht ne kemi qenë të gjithë të vetëdijshëm se kërkesa për formimin e shtetit e ri të Kosovës, do të nënkuptojë në një formë largim nga disa faktorë. Megjithatë kjo nuk nënkupton se tani ne do të duhej të hiqim dorë nga vetvetja. Heqja dorë nga këto data të rëndësishme, mund të duket se ne nuk kemi një të kaluar, kemi një të tashmë dhe sigurisht se do të kemi edhe një të ardhme. Heqja dorë nga e shkuara, automatikisht do të thotë heqje dorë edhe nga e ardhmja. Nuk ka popull në botë i cili nuk ka një të kaluar, dhe, edhe ne shqiptarët që jemi mbi 90% në Kosovë, kemi një të kaluar që është sa tragjike aq e lavdishme, prandaj duhet të respektohet.

Tani tendencat që me krijimin e shtetit të Kosovës të krijohet një identitet i ri në të gjitha format dhe sferat, në radhë të parë është i dëmshëm për vetë Kosovën, sepse atëherë ne nuk kemi një bazë të qëndrueshme mbi të cilën jemi krijuar. Në këtë pjesë të Ballkanit të quajtur Kosovë kemi pasur më dhjetëra e dhjetëra herë përpjekje të armiqve tanë për të na shkombëtarizuar, për të na ndarë nga pjesa tjetër e vendit. Por, që me rezistencë të vazhdueshme të gjeneratave të tëra është arrit që të ruhet kjo gjendje çfarë është sot. Kjo gjendje duhet të respektohet dhe të forcohet dhe as ne dhe askush nga jashtë neve nuk ka nevojë të frikësohet, pse ne jemi shqiptarë. Jemi shqiptarë dhe bashkësia ndërkombëtare e dinë si jemi ndarë, sepse nuk është kohë e gjatë kjo, dhe çdo përpjekje e kujtdo qoftë që të krijojë një shkëputje në mes të kombit shqiptarë në Kosovë dhe kombit shqiptarë në Shqipëri apo pjesë të tjera që jetojnë jashtë pjesës amë, është e papranueshme dhe e rrezikshme. Ne jemi këta që jemi dhe kështu si jemi duhet ta respektojmë së pari vetveten dhe pastaj të na respektojnë dhe çmojnë edhe të tjerët.

Focus: Pakoja e Ahtisaarit në të cilën thirren nuk thotë se duhet të hiqen nga kalendari 28 Nëntori, 24 Marsi apo 12 Qershori, megjithatë Kryeministri Thaçi paralajmërojë se ky është vetëm fillimi. Çfarë do të thotë kjo, ka edhe më shumë që mund të bëhet?

Makolli: Mënyrat e interpretimit të pakos së Ahtisaarit janë nga me të ndryshmet. Pakoja e Ahtisaarit jo që kërkon një gjë të tillë, përkundrazi e respekton secilin komunitet, respekton historinë, traditën dhe kulturën e tyre dhe në asnjë pjesë Presidenti Ahtisaari nuk ka kërkuar nga asnjë bashkësi etnike, duke përfshi edhe shqiptarët, të heqin dorë nga pjesa e tyre. Por, me propozimet e tij Ahtisari ka venë themelet për ndërtimin e një të ardhme të përbashkët, duke u mbështet në të kaluarën e tyre historike, kulturore dhe etnike. Sepse nuk mund të ndërtohet të ardhmen, duke u shkëput nga e kaluara dhe Presidenti Ahtisaari nuk parasheh diçka të tillë.

Focus: Por, përderisa serbëve thuhet se duhet t'u mbrohen kishat dhe trashëgimia kulturore, pse këtë gjë ne nuk ia mbrojmë vetvetes. A duhet që shumica vazhdimisht të heq dorë nga gjërat e saja, për hir të mos frikësimit të pakicave, këtu theksohen serbët?

Makolli: Unë nuk konsideroj së 28 Nëntori e dëmton cilëndo pakicë në Kosovë. 28 Nëntori nuk është datë e shënuar kundër ndonjë pjesë të qytetarëve në Kosovë, ajo është si datë e shënuar për popullin shqiptarët që nuk është në kundërshtim me popujt e tjerë. Prandaj në asnjë rast 28 Nëntori nuk është festë që tani bëhet në kurriz të të tjerëve, madje shqiptarët në përgjithësi kanë treguar tolerancë të madhe në respektimin e historisë, traditës, kulturës dhe vlerave të popujve të tjerë në Ballkan. Tani kjo gjë të zhvendoset me arsyen se serbët nuk e dëshirojnë datën 28 Nëntor, kujtojnë se është e paqëndrueshme. Nuk ka pasur asnjë reagim të vetëm nga serbët për 28 Nëntorin. Unë besoj se edhe pjesëtarët e komunitetit serbë do ta respektojnë ditën e kombit shqiptarë, sikurse që edhe shqiptarët do ta respektojnë ditën e kombit serbë.

Mst: Nuk mund të vendos koalicioni qeveritar

Focus: Pajtoheni me konstatimet se kjo qeveri është duke punuar ad-hoc dhe se gjërat vazhdimisht po i drejton mbrapsht?

Makolli: Ajo që ne kemi theksuar në vazhdimësi që nga themelimi i kësaj qeverie, se ka veprime ad-hoc, për fat të keq po vjenë në shprehje, po shihet dhe preket. Por, po ashtu jam shumë i vetëdijshëm që ligjet e tilla kanë filluar të ndërtohen moti dhe në të cilat ka marr pjesë i gjithë spektri politikë dhe jopolitik kosovarë. Për me tepër ajo që do të duhej të shtronim si dilemë është, se hartimi i këtyre ligjeve nuk përcillet me një mendim politikë dhe mbështetje në një debat të mirëfilltë nga ana e institucioneve, sepse edhe Kosova tani duhet të ndërtoj ligje të cilat do të jenë të implementueshme dhe jo sa për të hartuar ligje dhe për t'u arsyetuar, dhe të themi se ja ne kemi ligje me bollëk, por që janë të paimplementueshme. Gjithsesi edhe përgjegjësia ndahet sipas hierarkisë dhe institucioneve që janë të thirrura, sepse në këtë rast askush nuk mund t'i ikë përgjegjësisë.

Focus: Nëse do të thirrshim në zbatimin strikt të pakos së Ahtisaarit, atëherë nga gjashtë deri në nëntë muaj pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës do të duhej të shkonim në zgjedhje të reja, por që koalicioni aktuale duket se nuk është e interesuar për këtë. Ju jeni për domosdoshmërinë e respektimit të kësaj dispozite të pakos?

Makolli: Nganjëherë sikur është bastarduar pakoja e Ahtisaarit dhe jo gjithçka kërkon pakoja e Ahtisaarit, po flasim për çështje të cilën e biseduam me lartë. Jo çdo gjë që po nxjerrim ne me ligje parasheh pakoja e Ahtisaarit në mënyrë decisive. Sa i përket çështjes së zgjedhjeve, nëse Kuvendi i Kosovës e ka pranuar pakon e Ahtisaarit si të tillë, nëse është pranuar nga Kuvendi i Kosovës dhe ky Kuvend ka qenë shumë i vetëdijshëm se ndër pikat që janë në atë propozim, është që zgjedhjet duhet të mbahen në periudhën nga gjashtë deri në nëntë muaj nga bartja e kompetencave në institucionet vendore dhe hyrja në fuqi e Kushtetutës, atëherë ajo duhet të zbatohet si e tillë.

Në këtë çështje duhet të jemi të përgjegjshëm, sepse ose duhet të respektohet ose jo pakoja. Ne edhe ashtu kemi mos respektim të pakos së Ahtisaarit nga një pjesë e popullatës së Kosovës. Por, institucionet e Kosovës të cilat janë zotuar edhe para ndërkombëtarëve dhe vendorëve se do ta zbatojnë me përpikëri planin e Presidentit Ahtisaari, tanimë nuk kanë asnjë arsye që pjesët e caktuara të kësaj pakoj të mos i respektojnë. Mosrespektimi qoftë vetëm edhe i një pike të kësaj pakoje, atëherë krijon mundësinë që të mos respektohen edhe pjesët tjera të pakos. Mos të harrojmë se në këtë pako ka edhe pjesë të atilla që e dëmtojnë rendë funksionalitetin e shtetit të Kosovës, por megjithatë është pranuar si e tillë, edhe pse kemi qenë shumë të vetëdijshëm se me këtë pako po hymë në një fazë shumë të paqartë për të ardhmen e Kosovës, por është pranuar. Ne kemi dëgjuar zëra që thonë se pjesë të planit të Ahtisaarit tani po i pëlqejnë opozitës, sepse po kërkojnë zgjedhje. Plani i Ahtisaarit është pranuar nga Kuvendi i Kosovës, që është organi me i lartë në Kosovë dhe çdo përpjekje e cilito subjekt politikë për të akuzuar të tjerët, se po kërkojnë të respektohet plani i Ahtisaarit, sepse po u konvenon mbajtja e zgjedhjeve, është deklarim shumë i papërgjegjshëm, ngase kështu shkelet mbi vendimin e Kuvendit të Kosovës. Nëse ka hezitime për këtë plan, ai duhet të hedhet edhe një herë për votim në Kuvendin e Kosovës dhe i vetmi është ky Kuvend, i cili mund ta heq ndonjë pjesë apo në tërësi këtë pako të presidentit Ahtisaari. Por, jo dëshirat e opozitës apo koalicionit qeveritarë dhe të tjerëve.

Focus: Ju shihet se do të insistoni që kjo pikë të respektohet nga koalicioni qeveritarë, por çfarë nëse ata nuk e bëjnë këtë, sepse kanë shumicën në Kuvend. Si do të veproni ju?

Makolli: Nuk mund të vendos koalicioni qeveritar, sepse ky është një vendim i Parlamentit të Kosovës dhe institucionet e dala nga Kuvendi i Kosovës duhet t'i respektojnë vendimet e këtij Kuvendi. Nëse Kuvendi i Kosovës vendos ndryshe, pavarësisht se koalicioni qeveritar ka shumicën, ne të gjithë jemi deklaruar se i respektojmë procedurat demokratik dhe çdo vendim tjetër që merr Kuvendi i Kosovës, pavarësisht mospajtimeve tona si opozitë, për shkak se numerikisht jemi të vegjël, të gjithë ne duhet t'i bindemi vullnetit të Kuvendit të Kosovës, por, assesi vullnetit të institucioneve të tjera apo subjekteve politike. Po e përsëris, sepse këtu ka pasur përpjekje të cilat do të doja t'i bartë në një nivel shumë të ulët, që të fajësohen pjesë të opozitës dhe për t'i paraqitur para popullit me idenë se këta janë për ta respektuar pakon e Ahtisaarit dhe se kjo pako është në kundërshtim me vullnetin e popullit. Për më tepër, një pjesë e opozitës që është sot në Kuvendin e Kosovës, qoftë për të mirë apo për të keq, nuk ka as me të voglin faj apo meritë për këtë pako, sepse nuk kemi qenë pjesë e Kuvendit kur është pranuar. Ne nuk po kërkojmë asgjë me tepër, sesa të respektohet një vendim i institucionit me të lartë në Kosovë, siç është Kuvendi. Nëse ky Kuvend e sheh ndryshe, atëherë neve nuk na mbetet asgjë tjetër, përveç që ta bindim Kuvendin që të vendos ndryshe, por ai është i vetmi institucion që vendos për këtë çështje dhe jo dikush tjetër.

Focus: Sa e zëshme apo e pandikuar është Aleanca Kosova e Re (AKR) brenda Kuvendit të Kosovës si opozitë, ngase shpesh herë ka tingëlluar ose është dukur sikur ju mbani krahun e qeverisë për çështje të caktuara?

Makolli: Kjo është varësisht nga këndi që shikohet apo lexohet. Duhet të jemi të vetëdijshëm se ka pasur çështje në Kosovë të cilat nuk kanë qenë pjesë as të pozitës dhe as opozitës, sepse ka pasur përkushtime të përbashkëta, siç është shpallja e pavarësisë së Kosovës, ligjet që dalin nga pakoja e Ahtisaarit, Kushtetuta e Kosovës. Për këtë të gjithë kemi qenë të përkushtuar që të ndërtojmë të ardhmen e vendit tonë dhe pasojat si për të mirë apo për të keq nuk i bartë as pozita dhe as opozita, por të gjithë. Në pjesë të tjera të aktiviteteve të përgjithshme të qeverisë ne jemi sjell ndryshe dhe këtu nuk besoj se AKR-ja ka dalë apo është dukur sikur është pjesë e qeverisë. E kemi theksuar shumë herë që duke qenë të relaksuar brenda Kuvendit të Kosovës, pa hipoteka në të kaluarën, do të jemi opozitë konstruktive brenda Kuvendit të Kosovës. Kemi konsideruar dhe konsiderojmë se në Kuvendin e Kosovës duhet të ketë qasje krejt ndryshe nga ajo që ka ekzistuar deri më tani. Që Kuvendi i Kosovës të mos jetë vetëm një vend që është për kritika të opozitës nga pozitës ose mbrojtje të pozitës nga opozita, po të jetë një vend ku debatohet, ku kritikohet me fakte, por mbi të gjitha një vend ku ofrohen alternativa. Ne në aktivitete tona brenda Kuvendit të Kosovës dhe jashtë tij jemi përpjek dhe po përpiqemi që të ofrojmë alternativa të cilat konsiderojmë se janë shumë me të suksesshme sesa ato që i propozon qeveria për të zgjidhë problemet në fushat e ndryshme të jetës në Kosovë. Ne nuk jemi në Kuvend vetëm të kritikojmë, por edhe të ofrojmë alternativa. Megjithatë në asnjë rast nuk do të hezitojmë që ato veprime të qeverisë të cilat janë në të mirë të qytetarëve t'i pranojmë si të tilla, sepse të qenit në opozitë nuk do të thotë se duhet të mohosh çdo gjë që vjen nga pozita.

Mst: AIK-ja nuk benë assesi të jetë nën ndikimin e politikës, sepse është fatkeqësi

Focus: Një Ligj tjetër që parasheh pakoja e Ahtisaarit dhe që kërkon të miratohet në Kuvend është ai i Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës, e që tani del se pozitë e larta të kësaj Agjencie do t'i ndajnë PDK, LDK dhe AAK. Mendoni se një hap i tillë dërgon këtë shërbim drejtë politizimit, futjes nën kontroll nga partitë politike për t'iu shërbyer interesave të caktuar në Kosovë dhe jo qytetarëve dhe sigurisë së vendit, e që në fund do t'ia shohim sherrin?

Makolli: Ne, sidomos si shqiptarë, kemi një të kaluar të hidhur me shërbime të tilla qoftë para, gjatë apo pas luftës. Çdo përpjekje e partive politike për ta futur nën sqetullën e tyre këtë institucion shumë të ndjeshëm për Kosovën dhe qytetarët e saj do të jetë fatal për të ardhmen e Kosovës. Ligji për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës është miratuar sot (dje) nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe këtë ligj e përcjellin një mori defektesh, që si të tilla këtë institucione e benë ndër institucionet me ndikimin më të madh në Kosovë. E nëse kësaj i bashkëngjisim edhe përpjekjet ose tendencat e subjekteve politike që në krye të këtij institucioni të vendosen militantët partiak politikë, atëherë thjeshtë e ardhmja e këtij vendi dhe qytetarëve do të vihet në rrezik shumë të madh. Qartazi Kosova duhet të ndërtoj një agjencia të kësaj natyre i cili do të jetë në shërbim të sigurisë së vendit dhe jo në shërbim të subjekteve politike. Mos të harrojmë dhe këtë duhet ta kenë parasysh dhe udhëheqësit e subjektet politike që kanë pretendime të tilla, se në shumë vende të botës pikërisht këto agjencinë që kanë qenë nën direktivat e subjekteve të ndryshme politike kanë qenë elementet kryesore për t'i shkatërruar ato. Këtu shoqëria kosovare duhet të jetë shumë e vëmendshme që edhe Kosovës të mos i ndodh diçka e tillë dhe kujtojeni se probleme të kësaj natyre me këso agjencish ka edhe në ShBA, në Maqedoni, Greqi, etj, e të mos flasim për Shqipërinë. Prandaj shoqëria jonë dhe subjektet politike duhet të jenë shumë të vëmendshme, ngase jo pak njerëz edhe nga subjektet që ju përmendi kanë pësuar pikërisht nga agjencitë e tilla në të kaluarën jo shumë të largët dhe nuk dua të besoj se po këta njerëz do ta bëjnë një gabim të tillë.

Focus: Si do të reagojë partia juaj, nëse këto parti politike marrin një vendim të tillë?

Makolli: Ligji nuk e lejon një gjë të tillë, ligji e përcakton qartazi edhe formën dhe i shkëput të gjitha mundësit që në krye të këtyre institucioneve të jenë njerëz të politikës. Nëse ndodh diçka e tillë dhe në shoqërinë kosovare mund të ndodhë dhe kjo shihet. Por, së pari kemi të bëjmë me shkelje serioze të ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe unë besoj që edhe ne si subjekt politikë do të ndërmarrim të gjitha veprimet tona brenda kuadrit demokratik që të mos lejojmë një gjë të tillë. Do të bëjmë çdo gjë që ky agjencion të mos jetë i ndikuar nga politika, sepse do të jetë institucion që në vend që të jetë në mbrojtje të qytetarëve, do të jetë një instrument apo mjet në duart e njerëzve për t'i sanksionuar qytetarët e Kosovës. Këtu kontribut duhet të jap Komisioni Parlamentar dhe nëse ka tendenca të tilla do të bëjmë të gjitha përpjekjet e mundshme që i lejojnë veprimet demokratike, ndryshe mund të jetë me pasoja të mëdha për të ardhmen e vendit.

Mst: UNMIK-u duhet të shkoj nga Kosova

Focus: Më 15 qershor do të duhej që bashkësia ndërkombëtare të vendoste për mënyrën e vazhimit të misioneve të saja në Kosovë dhe natyrisht UNMIK-u do të duhej të shkonte nga Kosova, por kjo gjë nuk shihet në horizont. A mund të bashkëjetojnë dhe bashkë-udhëheqin në Kosovës UNMIK-u dhe EULEX-i?

Makolli: Unë nuk them se do të duhej të shkonte, por duhet të shkoj, sepse Kushtetuta e Kosovës në momentin kur fillon se zbatuari në praktikë, që është përcaktuar më 15 qershor, nuk njih mision në Kosovë me emrin UNMIK dhe deri në atë kohë administrata e UNMIK-ut duhet që të gjitha kompetencat e parapara me Kushtetutë t'i bart tek institucionet e Kosovës. Natyrisht tani është krijuar një përplasje mes bashkësisë ndërkombëtare, mes OKB-së dhe BE-së sa i përket kësaj çështje. Në asnjë moment nuk mund të bashkëjetojnë nën çfarëdo ombrelle të mundshme UNMIK-u dhe EULEX-i në Kosovë. UNMIK-u përfundon mandatin e tij me gjithë të mirat dhe të këqijat e tij të pranishme së tij në Kosovë. Megjithatë kosovarët i janë falënderues UNMIK-ut për të gjitha ato që ka bërë në Kosovë, por është koha që UNMIK-u t'i thotë lamtumirë Kosovës. UNMIK-u ka ardhur në Kosovë edhe me misionin që t'i përgatis institucionet e Kosovës,

që ato të menaxhojnë vet me Kosovën. Kosova nuk ka mundësinë që të administrohet nga bashkësia ndërkombëtare edhe më tutje dhe nëse tani UNMIK-u dorëzon kompetencat tek institucionet e Kosovës, atëherë mund të thuhet se UNMIK-u deri diku suksesshëm e ka përfunduar misionin e vet në Kosovë, sepse ka arrit që të përgatis, të krijojë kushte ligjore, praktike, profesionale dhe kadrovike për institucionet e Kosovës. Me Kushtetutë është misioni i EULEX-it i cili ka përgjegjësit dhe kompetencat e veta. UNMIK-u nuk e ka kontestuar Kushtetutën e Kosovës si një dokument i pranuar ndërkombëtarisht dhe UNMIK-u duhet ta respektojë Kushtetutën e Kosovës në të cilën ka marr pjesë edhe vet në hartimin e saj. Këtu nuk ka çka të thuhet më tepër, përveç që të kemi një përshëndetje dhe falënderim për të gjithë ata që kanë qenë pjesë e misionit të UNMIK-ut që nga fillimi deri më tani. Mbetja edhe më tej e këtij misioni në Kosovë, si dhe vendosja e atij të BE-së do të krijojnë probleme dhe do të ishte gabim fatal për neve, sepse do të bllokoni proceset politike në Kosovë.

Focus: A do të ishte gabim fatal dhe përligjje i zgjedhjeve lokale të Serbisë të mbajtura më 11 maj në Kosovë, nëse vërtet EULEX-i zbaton deklaratën se do të bisedoj edhe me “të zgjedhurit” serbët më 11 majit dhe kjo të legjitimoj ndarjen etnike në Kosovë?

Makolli: Nëse ka ndodh një gabim me rastin e lejimit të mbajtjes së tyre, në asnjë rast nuk duhet të lejohet gabimi i dytë, pasojat e të cilit do të jenë të pakthyeshme për funksionimin e Kosovës si tërësi, por do të jenë për më tepër pasoja të pakthyeshme, të pariparueshme në ndërtimin e raporteve të mira ndëretnike. UNMIK-u dhe EULEX-i ndaj atyre të ashtuquajtur të zgjedhur në zgjedhjet e Serbisë më 11 maj, duhet të silltet si me çdo qytetar tjetër të Kosovës dhe absolutisht nuk duhet të pranojnë diçka të tillë. Kjo pavarësisht se mund të thuhet se është një vullnet i qytetarëve, institucionet e Kosovës menjëherë, pasi të fillojë së zbatuari Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duhet që në këto vende të cilat nuk kanë pasur zgjedhje të organizohen zgjedhje ose të shihen forma të tjera, sepse ne edhe ashtu pas 14 muajve kemi zgjedhjet tjera lokale. Por këta njerëz që janë zgjedhur në ato zgjedhje nuk janë njerëz me të cilët do të duhej të bisedohej, kushdo qofshin ata.

Mst: Carla del Ponte do të duhej të ndiqej nga drejtësia ndërkombëtare

Focus: Para se të futeni në politikë keni qenë shef i KMLDNJ-së. Ju si këshill keni pasur informata se gjatë vitit 1999-2000 kanë ndodhur rrëmbime dhe transportime të njerëzve nga Kosova drejtë Shqipërisë për trafikim organesh, siç ka shkruar në librin e saj ish Kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës, Carla del Ponte?

Makolli: Ne kemi pasur më mijëra aktivistë, jo vetëm brenda territorit të Kosovës, por edhe në të gjitha vendet e rajonit të cilët me përpikërinë me të madhe kanë hulumtuar rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe rastet e krimeve të luftës. Asnjë element më i vogël nuk është paraqitur nga këta hulumtues për diçka të tillë. Tanimë qartazi po shihet se ish Kryeprokurorja Tribunalit të Hagës, për fat të keq që ka qenë Kryeprokurore, sepse institucioni me i lartë i drejtësisë do të duhej të kishte kujdes se kë e vendos në krye të institucioneve të tilla, ngase skajshmërisht ka treguar se është kundër shqiptarëve dhe natyrisht nuk ka mundur të jetë objektive në gjykimet e saja. Për më tepër Carla del Ponte do të duhej të ndiqej nga drejtësia ndërkombëtare, jo me iniciativën e kosovarëve, por me iniciativën e Tribunalit të Hagës. Nëse ajo ka pasur fakte për diçka të tillë, ajo ka qenë në krye të institucionit i cili do të duhej të urdhëronte diçka të tillë dhe nëse ajo ka fshehur diçka të tillë, ajo do të duhej të përgjigjej para organeve të drejtësisë. Kjo është një gënjeshtër shumë e madhe e Carla del Pontes që të hakmerret personalisht kundër shqiptarëve.

Institucionet e Kosovës duhet që të mos lenë mekanizëm dhe as instrument vendor dhe as ndërkombëtar pa e përdorë në mënyrë që kjo deklaratë e Del Pontes të marr drejtimin e duhur të drejtësisë. Ka pasur edhe aso mendimesh se kjo është një gënjeshtër dhe nuk kemi nevojë të flasim, ngase ne e dimë se ka qenë e tillë. Por brezat pas neve nuk do ta dinë, sepse ata nuk janë në këtë kohë që t'i shohin gjërat dhe kjo do të përdoret si burim për historianët e ndryshëm. Prandaj institucionet e Kosovës nuk duhet te lenë instrument ndërkombëtar pa e përdorë në mënyrë që drejtësia ndërkombëtare ta thotë fjalën e vetë për këtë. Jam në favor të asaj që institucionet e Kosovës të ftojnë organizatat me të specializuara në botë që të vijnë dhe të hulumtojnë çdo pjesë të Kosovës, sepse është në interesin e Kosovës si viktimë që kemi qenë, që para botës të tregojmë se shqiptarët nuk kanë qenë ata që kanë kryer krime kundër njerëzimit, por janë pikërisht viktima.

Focus: Edhe organizata ndërkombëtare Human Rights Watch ka thënë se ka diçka të tillë në dorë dhe se ka parë disa fakte, prandaj ka kërkuar nga institucionet e Kosovës dhe të Shqipërisë që ato vetë të hetojnë këtë çështje dhe të dalin para opinionit vendas dhe ndërkombëtar për të vërtetat e kësaj ngjarje?

Makolli: Si duket është keqkuptuar në opinionin kosovarë. Organizata Human Rights Watch është organizatë shumë e respektueshme në botë në fushën e të drejtave të njeriut dhe kjo sikur çdo organizatë tjetër për të drejtat e njeriut është e obliguar që në momentin e parë, kur dikush hedhë në opinion ndonjë dyshim mbi diçka, që të kërkojë hetime. Human Rights Watch nuk ka bërë asgjë me tepër sesa që ka kërkuar që deklaratën e Carla del Pontes, institucionet e Kosovës dhe Shqipërisë t'i hetojnë dhe këto akuza që benë ajo t'ua mundësoj hetuesve ndërkombëtar t'i vërtetojnë se a janë të vërteta apo jo. Kujtojmë se organizata Human Rights Watch me këtë kërkesë që ka bërë ka kryer një pjesë të misionit të saj si organizatë për të drejtat. Ajo nuk ka thënë se ka elemente të saja, por mbështete në dyshim. Kështu jemi mbështet edhe ne si Këshill për të Drejta të Njeriut. Kur kemi pas një informatë se diçka mund të ketë diku, kemi filluar hetimet. Unë kam hetuar edhe veprime të njerëzve të cilët nuk e njohin veprimtarinë e Fred Abrahams, i cili gjatë kohës sa ka vepruar në Kosovë, që nga vitet '90-ta, ka demaskuar vazhdimisht dhe pandërprerë abuzimet e regjimit të Millosheviqit.

Focus: Por tani doli me një shkrim autorial vet Abrahams, i cili kërkon që institucionet e Kosovës të jenë ato që do të hetojnë këtë çështje, për të dëshmuar me këtë para botës se është vend që respekton ligjin dhe mund të funksionoj si shtet?

Makolli: Ne nuk kemi kapacitete të tilla, sepse po të kishim diçka të tillë, do ta zbulonim fatin e rreth 2000 njerëzve të zhdukur. Nuk kemi kapacitete as njerëzore dhe në ekspertizë apo mjete, sepse janë të kushtueshme dhe Kosova si ka sot. Ajo që do të duhej të bënte Kosova është që jo vetëm t'u hapë dyert, por të bashkëpunoj ngushtë me hetuesit ndërkombëtar të cilët do të vinin të hulumtonin diçka të tillë. Vendi i cili akuzohet nuk mund të bëjë hetime. Në kohën e luftës kur Serbia përpiquej të bënte hulumtime për krimet që i zhvillonte në Kosovë, besueshmëria ndaj këtyre hulumtimeve ishte shumë e vogël. Unë se pari nuk do t'u besoja, prandaj për rastet e tilla është shumë i nevojshëm një hetim ndërkombëtar i pavarur dhe vendorët do të duhej t'u ofronin logjistiken. Kosova vetëm duhet të ftojë ndërkombëtarët që të vijnë të bëjnë hulumtime përkitazi me këto akuza që i benë Del Ponte.

Në vazhden e kësaj, ndër të parët që ka reaguar ndaj akuzës së Del Pontes është Behxhet Pacolli, i cili ka angazhuar tanimë tri ekipe studio avokatësh ndërkombëtar që të fillojnë veprimtarinë e hetimit të kësaj çështje. E para, që të hulumtohen faktet dhe të zbulohet e vërteta. E dyta, që Carla Del Ponte të jap përgjegjësi para drejtësisë ndërkombëtare dhe e treta, që libri i saj të tërhiqet nga tregu. Behgjet Pacolli është i përkushtuar që kësaj çështje t'i shkoj deri në fund, por ai ka nevojë që të ketë edhe mbështetjen e institucioneve të Kosovës, sepse do të ishte shumë me gjithëpërfshirës dhe nuk do të ishte

iniciativë e vetëm një individ, por do të ishte një iniciativë shtetërore. Megjithatë, mendoj se shoqëria vendore dhe ndërkombëtare do të duhej të lëshohej në një debat, sepse mos të harrojmë se kjo ka edhe efekt tjetër, për të barazuar kriminelin me viktimën.